

NJOFTIM GLOBAL PËR PRIVATËSINË

Përditësimi i fundit: 10 qershor 2025

Johnson Controls International plc dhe filialet e saj (së bashku, **Johnson Controls**) kujdesen për privatësinë tuaj dhe angazhohen t'i trajtojnë të dhënat tuaja personale në përputhje me praktikatat e trajtimit me korrektësi të të dhënave dhe ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Si shenjë e angazhimit tonë lidhur me privatësinë, kemi adoptuar një sërë Rregullash të Detyrueshme të Korporatës ("RRDK"). Këto përmbajnë angazhimin tonë në rang global për çështjet e privatësisë dhe përfshijnë politikat tona për transferimin e të dhënave personale dhe të drejtat individuale përkatëse të privatësisë, me qëllim garantimin e mbrojtjes së të dhënave tuaja personale, gjatë trajtimit të tyre nga filialet tona nëpër botë. Këto RRDK janë aprovuar nga Autoritetet Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave. RRDK tona mund t'i gjeni tek Portali i Privatësisë.

1. Qëllimi

Ky njoftim global shpjegon se si Johnson Controls trajton të dhënat personale të punonjësve, aplikuesve, stazhierëve, ish punonjësve, vartësve, përfituesve, kontraktorëve, këshilltarëve dhe punonjësve të përkohshëm të agjencive gjatë veprimtarisë së saj.

Të dhënat personale nënkuptojnë çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm; dikush që mund të identifikohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, nga një element identifikues, si emri, një numër identifikimi, të dhëna të vendndodhjes, element identifikues online ose një a më shumë faktorë specifikë që lidhen me identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të këtij personi fizik.

Kategoritë speciale të të dhënave personale (të njohura gjithashtu si "të dhënat personale të ndjeshme") nënkuptojnë të dhënat personale që tregojnë origjinën raciale ose etnike, opinionet politike, besimet fetare ose filozofike, anëtarësimin në sindikata dhe përpunimin e të dhënave lidhur me jetën shëndetësore apo seksuale, të dhënat gjenetike ose ato biometrike.

2. Identiteti i kontrolluesit të të dhënave

Përgjithësisht, entiteti Johnson Controls përgjegjës për përpunimin e të dhënave tuaja personale (shpesh referuar si 'kontrolluesi i të dhënave'), është entiteti Johnson Controls me të cilin ke një marrëdhënie punësimi (ose, nëse nuk je një punonjës, entiteti Johnson Controls përgjegjës për punën tënde). Nëse keni paqartësi, mund të kontaktoni departamentin e burimeve njerëzore ose Zyrën e çështjeve të privatësisë (privacy@jci.com).

3. Kategoritë e të dhënave personale

Në ecurinë normale të proceseve të burimeve njerëzore dhe veprimtarive të biznesit, ne mbledhim dhe përpunojmë kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale:

Të dhëna për identifikimin personal	Të dhëna të tilla si emri, vendi i lindjes, adresa e shtëpisë, data e lindjes, gjinia, fotografi që lidhen me punën, numri i telefonit të shtëpisë dhe adresa personale e emailit.
Numrat e identifikimit të lëshuar nga shteti	Numri i pasaportës, numri i sigurimeve shoqërore dhe/ose numri kombëtar i identifikimit,
Të dhëna rreth të drejtës së punës	Të dhëna për statusin tuaj të emigrantit, të drejtën për punë dhe statusin e rezidentit.
Të dhënat e kontaktit të familjes dhe të emergjencës	Emri/-at dhe të dhënat e kontaktit të anëtarëve të familjes suaj dhe/ose kontaktet e emergjencës.
Të dhëna rreth punësimit	Të dhëna që lidhen me punësimin/punën tuaj për Johnson Controls, si vitet e shërbimit, vendndodhja e punës, numri i identifikimit të punësimit, të dhënat e punës, mungesat gjatë pushimeve vjetore dhe të dhënat kontraktuale.

Të dhëna rreth arsimimit dhe trajnimeve	Të dhëna që lidhen me arsimimin dhe trajnimet, si diplomat shkollore, certifikatat dhe licencat, të dhënat profesionale dhe pjesëmarrjen në trajnimet e brendshme.
Të dhëna rreth rekrutimit dhe performancës	Të dhëna si objektivat e karrierës, klasifikimet, komentet, rezultatet e përshtypjeve, historiku i karrierës, pajisjet e punës, planifikimi i karrierës dhe i pasuesve, aftësitë dhe kompetencat, si dhe kualifikime të tjera të punës dhe të dhëna të përgjithshme.
Të dhëna që lidhen me përdorimin nga ana juaj të aseteve të Johnson Controls	Të dhëna që lidhen me përdorimin veçanërisht të kompjuterëve të Johnson Controls, aparateve celulare dhe sistemeve të telekomunikacionit si dhe trafikut të gjeneruar në internet.
Të dhëna të mbledhura nga softueri i menaxhimit të pajisjes celulare	Të dhënat e mbledhura nga softueri i menaxhimit të aparateve celulare të Johnson Controls, ku përfshihet emri juaj, numri i celularit, adresa e emailit të biznesit, shteti i ofruesit tuaj të shërbimeve celulare dhe të dhënat e përfshira në aplikacionet e korporatës të instaluar në pajisjen tuaj.
Të dhëna rreth konformitetit dhe menaxhimit të riskut	Të dhënat e kërkuara për konformitetin dhe menaxhimin e riskut, siç janë të dhënat disiplinore, raportet e kontrolleve të precedentëve personalë dhe të dhënat e sigurisë.
Të dhëna që lidhen me listëpagesën dhe pagesat ose përfitimet	Të dhëna të tilla si statusi martesor, të dhëna për pagën dhe sigurimet, të dhëna të vartësve, identifikuesi shtetëror ose numrat e taksave, të dhënat e llogarisë bankare dhe të dhëna rreth përfitimeve të punësimit, të dhëna për familjen dhe vartësit.
Të dhëna për vendndodhjen dhe frekuentimin	Të dhëna që lidhen me vendndodhjen dhe kohën, si dhe menaxhimin e frekuentimit.
Të dhëna që lidhen me udhëtimet dhe pasaportën	Të dhëna që lidhen me udhëtimet [e punës] që keni ndërmarrë, duke përfshirë të dhënat e pasaportës.
Regjistrimet me zë/video që lidhen me biznesin	Regjistrimet me zë/video që lidhen me biznesin, për shembull, të mbledhjeve dhe/ose prezantimeve ku keni marrë pjesë.

Gjithashtu, mund të përpunojmë edhe kategori të veçanta të të dhënave personale, si për shembull:

Të dhëna rreth shëndetit dhe sëmundjeve	Këtu mund të përfshihen të dhëna të tilla si gjendja shëndetësore, simptomat, diagnozat, trajtimet dhe mjekimet kur ka qenë e nevojshme, certifikatat mjekësore dhe të dhënat për lëndime dhe sëmundje në vendin e punës.
Të dhëna lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë	Të dhëna që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë.
Raca dhe kombësia	Ky informacion mund të mblidhet kur nevojitet ose lejohet me ligj.
Të dhënat biometrike	Këtu mund të përfshihen të dhëna për njohjen e fytyrës, atje ku vendndodhjet tona përdorin sisteme të tilla, në përputhje me ligjin përkatës në fuqi.
Të dhëna të sakta të vendndodhjes gjeografike	Ne i përpunojmë këto të dhëna në situata ku roli juaj e kërkon këtë dhe ku lejohet nga ligji, duke përfshirë vendin ku përdorni një nga mjetet tuaja.
Anëtarësimi në sindikata	Të dhëna lidhur me anëtarësime që mund të keni në sindikata.
Të dhëna lidhur me precedentët tuaj penalë	Dënime ose procese penale dhe të dhëna lidhur me precedentë të tjerë personalë, aty ku e lejon ligji.
[Juridiksione të caktuara] Numri i pasaportës, numri i sigurimeve shoqërore ose numri kombëtar i identifikimit	Në juridiksione të caktuara, numri i pasaportës suaj, numri i sigurimeve shoqërore ose numri kombëtar i identifikimit klasifikohen si kategori e veçantë dhe/ose të dhëna personale të ndjeshme

[Vetëm për Indinë] Fjalëkalimet dhe të dhënat financiare	Në Indi, fjalëkalimet dhe të dhënat financiare (si llogaria bankare, karta e kreditit ose e debitit, ose të dhëna të tjera për instrumentet e pagesës) konsiderohen si të dhëna personale të ndjeshme.
---	--

Po ashtu edhe grumbullimi i të dhënave personale drejtpërdrejt nga ju, por mund t'i mbledhim edhe nga burime të tjera, ku përfshihen:

- Organizata qeveritare, ofrues shërbimesh shëndetësore dhe ofrues programesh përfitimesh;
- Kompanitë ose ofruesit e shërbimeve që kryejnë kontrole të precedentëve penalë;
- Supervizorët, kolegët ose rekomanduesve të emëruar; dhe
- Të dhënat e disponueshme për publikun.

4. Qëllimi dhe baza ligjore për përpunimit

Ne i mbledhim dhe i përpunojmë të dhënat personale për qëllimet e listuara më poshtë. Atje ku e kërkon ligji, do të mbështetemi në një ose më shumë baza ligjore, të cilat mund të përfshijnë miratimin tuaj paraprak. Për qëllimet e ligjit evropian të mbrojtjes së të dhënave, do të mbështetemi tek baza ligjore në tabelën e mëposhtme (shihni “Baza ligjore ku mbështetemi për këtë përpunim”).

Qëllimi për përpunimin e të dhënave personale	Të dhënat personale të përpunuara për këtë qëllim	Baza ligjore ku mbështetemi për këtë përpunim
Burimet njerëzore dhe punësimi: Këtu përfshihet administrimi i fuqisë punëtore, listëpagesat, kompensimi dhe programet e përfitimit, menaxhimi i performancës, të mësuarit dhe zhvillimi, përparimi dhe planifikimi i pasuesve.	Të dhëna për identifikimin personal Numrat e identifikimit të lëshuar nga shteti Të dhëna rreth të drejtës së punës Të dhënat e kontaktit të familjes dhe të emergjencës Të dhëna rreth punësimit Të dhëna rreth arsimimit dhe trajnimeve Të dhëna rreth rekrutimit dhe performancës Të dhëna që lidhen me listëpagesën dhe pagesat ose përfitimet Të dhëna për vendndodhjen dhe frekuentimin Kategoritë e veçanta të të dhënave personale Të dhëna rreth shëndetit dhe sëmundjeve Të dhëna lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë Të dhënat biometrike Të dhëna të sakta të vendndodhjes gjeografike Anëtarësimi në sindikata	Përpunimi na nevojitet që të zbatojmë kontratën tonë me ju, si për t’ju paguar dhe për të menaxhuar marrëdhëniet tuaja të punësimit me ne. Përpunimi është i nevojshëm për qëllime të zbatimit të detyrimeve dhe ushtrimit të të drejtave në lidhje me ligjin e punësimit. Atje ku raca përdoret për diversitet dhe gjithëpërfshirje, mund të mbështetemi në miratimin e shprehur.

	Raca dhe kombësia	
Planifikimi i fuqisë punëtore dhe rekrutimi	Të dhëna për identifikimin personal Numrat e identifikimit të lëshuar nga shteti Të dhëna rreth të drejtës së punës Të dhëna rreth punësimit Të dhëna rreth arsimimit dhe trajnimeve Të dhëna rreth rekrutimit dhe performancës Kategoritë e veçanta të të dhënave personale Raca dhe kombësia	Përpunimi na nevojitet që të zbatojmë kontratën tonë me ju, si për të menaxhuar marrëdhënien e punës me ju dhe për të caktuar punët. Përpunimi na nevojitet për të ndërmarrë hapa për lidhjen e një kontrate me ju. Për shembull, nëse aplikoni për punë tek ne. Atje ku raca përdoret për diversitet dhe gjithëpërfshirje, mund të mbështetemi në miratimin e shprehur.
Shkrirje biznesi, blerje dhe transferime	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna rreth punësimit Të dhëna që lidhen me listëpagesën dhe pagesat ose përfitimet <i>Në varësi të shkrirjes së biznesit, blerjes ose transferimit, kategori të tjera të mundshme të të dhënave personale të listuara në seksionin 3.</i>	Përpunimi nevojitet për qëllimin e interesave tona legjitime në lidhje me ndërmarrjen e shkrirjes së biznesit, blerjeve dhe transferimeve.
Pajtueshmëria ligjore , si dhe pajtimi me kërkesat e autoriteteve për informacione, hipotekat, sekuestrimet dhe pajtimi me detyrimet fiskale	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna rreth të drejtës së punës Të dhëna rreth punësimit Të dhëna që lidhen me listëpagesën dhe pagesat ose përfitimet <i>Në varësi të natyrës së detyrimit për pajtueshmëri, kategori të tjera të mundshme të të dhënave personale të listuara në seksionin 3.</i>	Përpunimi nevojitet për t'u pajtuar me një detyrim ligjor të cilit i nënshtrohet Johnson Controls.

Menaxhimi i personelit, siç janë programet e udhëtimeve dhe shpenzimeve si dhe programet e brendshme të shëndetit dhe sigurisë	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna rreth punësimit Të dhëna që lidhen me udhëtimet dhe pasaportën Të dhëna që lidhen me listëpagesën dhe pagesat ose përfitimet Kategoritë e veçanta të të dhënave personale Të dhëna rreth shëndetit dhe sëmundjeve Të dhëna lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë	Përpunimi na nevojitet që të zbatojmë kontratën me ju, si për të menaxhuar fuqinë punëtore dhe për t'u mundësuar punonjësve tanë udhëtimet, shpenzimet dhe programet e shëndetit dhe sigurisë. Përpunimi është i nevojshëm për qëllime të zbatimit të detyrimeve dhe ushtrimit të të drejtave në lidhje me ligjin e punësimit.
Raportimi i brendshëm dhe auditit	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna rreth punësimit Të dhëna që lidhen me listëpagesën dhe pagesat ose përfitimet Të dhënat e nevojshme për pajtueshmërinë dhe menaxhimin e riskut <i>Në varësi të natyrës së raportit ose auditit, kategori të tjera të mundshme të të dhënave personale të listuara në seksionin 3.</i>	Përpunimi nevojitet për qëllimin e interesave tona legjitime në realizimin e raportimeve të brendshme dhe kryerjen e auditeve.
Për mbrojtjen e Johnson Controls, personelit të tij dhe publikut nga dëmtimet, vjedhjet, përgjegjësia ligjore, mashtrimet ose abuzime apo lëndime të tjera	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna rreth të drejtës së punës Të dhënat e kontaktit të familjes dhe të emergjencës Të dhëna që lidhen me përdorimin nga ana juaj të aseteve të Johnson Controls Të dhëna të mbledhura nga softueri i menaxhimit të pajisjes celulare Të dhënat e nevojshme për pajtueshmërinë dhe menaxhimin e riskut Kategoritë e veçanta të të dhënave personale Të dhëna lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë Të dhënat biometrike Të dhëna lidhur me precedentët tuaj penalë	Përpunimi nevojitet për interesat tona legjitime në mbrojtjen e Johnson Controls, personelit të tij dhe publikut nga dëmtimet, vjedhjet, përgjegjësia ligjore, mashtrimet ose abuzime apo lëndime të tjera. Përpunimi mund të nevojitet gjithashtu për t'u pajtuar me një detyrim ligjor të cilit i nënshtrohet Johnson Controls. Përpunimi është i nevojshëm për qëllime të zbatimit të detyrimeve dhe ushtrimit të të drejtave në lidhje me ligjin e punësimit.

Trajnime dhe demonstrim produktesh	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna rreth arsimimit dhe trajnimeve Regjistrimet me zë/video që lidhen me biznesin	Përpunimi nevojitet për interesat tona legjitime në ofrimin e trajnimeve dhe kryerjen e demonstrimeve të produkteve.
Zhvillimi i produktit që do të përfshijë ose do të lidhet me punonjësit	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna rreth punësimit <i>Në varësi të natyrës së zhvillimit të produktit, kategori të tjera të mundshme të të dhënave personale të listuara në seksionin 3.</i>	Përpunimi nevojitet për interesat tona legjitime në zhvillimin e produkteve të reja dhe vlerësimin e efikasitetit të tyre.
Monitorimi dhe filtrimi i përdorimit të pajisjeve, rrjetit tonë dhe trafikut të internetit për qëllime ligjore të biznesit, si dhe veçanërisht për:: • Garantimin e integritetit të përshtatshëm të sistemeve të informacionit si dhe detektimin dhe parandalimin e veprimtarive kriminale, duke përfshirë krimet informatike; • Mbrojtjen e informacionit, duke përfshirë e pa u kufizuar në të dhënat personale, të dhënat konfidenciale dhe të dhënat vlefshme të biznesit, nga shkatërrimi, humbja, tjetërsimi, qasja e paautorizuar, zbulimi ose pirateria informatike; • Sigurimin e përdorimit efektiv të sistemeve të saj të informacionit; • Garantimin e përputhshmërisë me detyrimet e aplikueshme rregullatore dhe vetë-rregulluese; • Detektimin e rasteve të mospërputhshmërisë me politikat e Johnson Controls për përdorimin e internetit dhe me Kodin e Etikës. Ju lutemi, kini parasysh: Nëse softueri i menaxhimit të pajisjes celulare është instaluar në pajisjen tënde personale (në mënyrë që të kesh qasje në emailin e Johnson Controls, shërbimet e rrjetit dhe të dhënat), Johnson Controls mund të duhet të bëjë ndryshime në konfigurimin e sigurisë së pajisjes, në mënyrë që të jesh në pajtim me kërkesat e Johnson Controls për sigurinë e pajisjeve celulare. Çdo monitorim dhe/ose filtrim i përdorimit të kësaj pajisjeje, për qëllimet e përmendura më sipër, është i kufizuar në zbatimin nga ana e korporatës. Për më shumë informacion, shiko ‘Si të na kontaktosh’ më poshtë.	Të dhëna për identifikimin personal Të dhëna që lidhen me përdorimin nga ana juaj të aseteve të Johnson Controls Të dhëna të mbledhura nga softueri i menaxhimit të pajisjes celulare Të dhënat e nevojshme për pajtueshmërinë dhe menaxhimin e riskut	Përpunimi nevojitet për interesat tona legjitime në garantimin e integritetit të sistemeve tona të informacionit. Përpunimi mund të nevojitet gjithashtu për t’u pajtuar me një detyrim ligjor të cilit i nënshtrohet Johnson Controls.

5. Marrësit e të dhënave personale

Kategoria e marrësit	Qëllimi për zbulimin e të dhënave personale
Entitete të tjera të Johnson Controls	Ne mund t'u zbulojmë të dhëna personale entiteteve të tjera të Johnson Controls që kryejnë shërbime për llogarinë tonë, për qëllimet e listuara në seksionin 4.
Ndërmarrjet e përbashkëta, nënkontraktorët, shitësit ose furnitorët	Ne mund t'u zbulojmë të dhëna personale ndërmarrjeve të përbashkëta, nënkontraktorëve, shitësve dhe furnitorëve që kryejnë shërbime për llogarinë tonë, për qëllimet e listuara në seksionin 4.
Një organizatë e sapokrijuar ose blerëse	Nëse Johnson Controls është përfshirë në një shkrirje biznesi, shitje ose transferim të disa ose të gjitha bizneseve të tyre, të dhënat personale mund t'u zbulohen organizatave të sapokrijuara ose blerëse.
Ofruesit e shërbimit të palës së tretë	Të dhënat personale mund të ndahen me ofrues shërbimesh të palës së tretë që na ndihmojnë të kryejmë veprimtaritë tona të biznesit, për shembull, ofruesit e shërbimeve IT, ofruesit e shërbimit të listë-pagesave dhe këshilltarët (si avokatët, llogaritarët dhe auditorët).
Marrësit të cilëve [ligjërisht] duhet t'u zbulojmë të dhënat personale	Ne mund t'i zbulojmë të dhënat personale për të qenë në pajtim me një detyrim ligjor të cilit i nënshtrohet Johnson Controls, si pajtueshmëria me një urdhër gjykatë ose ligj.
Marrësit që na keni lejuar t'u zbulojmë të dhëna personale	Ne mund t'u zbulojmë të dhëna personale marrësve aty ku e keni miratuar zbulimin, për shembull, atje ku nevojitet për kontrollet verifikuese të punësimit.
Marrësit që mund të marrin të dhëna personale në një emergjencë me rrezik për jetën	Aty ku është logjikisht e arsyeshme, në rastin e një emergjence me rrezik për jetën, mund t'ua zbulojmë të dhënat personale palëve të treta, për shembull, për t'u siguruar që do të ofrohet kujdesi i duhur në raste emergjencash.

6. Transferimet ndërkombëtare

Palët e treta, kompanitë e varësisë dhe filialet, tek të cilat mund të zbulohen të dhënat tuaja personale mund të ndodhen në gjithë botën, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Indinë, Sllovinë dhe Meksikën; për këtë arsye, të dhënat mund të dërgohen në vende me ligje të privatësisë të ndryshme nga ato të vendit tuaj të rezidencës. Në disa raste, gjykata, agjencitë ligjzbatuese, agjencitë rregullatore ose autoritetet e sigurisë në ato vende të tjera, mund të kenë të drejtën të kenë qasje të dhënat tuaja personale. Siç kërkohet nga ligji në fuqi, ne marrim masat e nevojshme për të garantuar që të dhënat tuaja personale të kenë nivelin e duhur të mbrojtjes, ku përfshihen edhe Rregullat e Detyrueshme të Korporatës, duke shpalosur standardet tona të larta për përpunimin e të dhënave personale si dhe Termat Standarde të Kontratës. Atje ku nevojitet, në përputhje me ligjin lokal, mund të kërkojmë autorizimin tuaj.

Sistemi APEC për Rregullat e Privatësisë Ndërkufitare (CBPR): Praktikë e privatësisë së Johnson Controls, të përshkruara në këtë Njoftim Privatësie, pajtohen me Sistemin APEC të Rregullave të Privatësisë Ndërkufitare. Sistemi APEC CBPR ofron një kuadër për organizatat për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale të transferuara mes ekonomive pjesëmarrëse në APEC. Më shumë informacion rreth kuadrit APEC e gjeni këtu . Klikoni [këtu](#) për të parë statusin tonë të certifikimit CBPR të APEC.

Për transferimin nga Zona Ekonomike Europiane ("ZEE"), Mbretëria e Bashkuar dhe/ose Zvicra: Disa juridiksione jashtë ZEE/MB njihen nga Komisioni Evropian, qeveria e MB-së dhe /ose qeveria zvicerane për ofrimin e një niveli të përshtatshëm mbrojtjeje sipas standardeve të ZEE/MS/Zvicrës: listën e juridiksioneve të përshtatshme të ZEE, e gjeni [këtu](#), listën e juridiksioneve të përshtatshme të MB-së e gjeni [këtu](#) dhe listën e juridiksioneve të përshtatshme të Zvicrës e gjeni [këtu](#). Për transferimet nga ZEE, MB dhe/ose Zvicra në vende që nuk konsiderohen të përshtatshme nga Komisioni Evropian, qeveria e MB-së ose qeveria zvicerane (sipas rastit), kemi vendosur masa të posaçme, si klauzola standarde kontraktuale të adoptuara nga autoriteti përkatës, për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale. Punonjësit në ZEE, MB dhe Zvicër mund të marrin një kopje të këtyre masave duke na kontaktuar në përputhje me seksionin "Si të na kontaktoni" më poshtë

Nëse keni një çështje të pazgjidhur privatësie ose një shqetësim për përdorimin e të dhënave, të cilin nuk e kemi trajtuar në mënyrë të kënaqshme, kontaktoni me ofruesin e palës së tretë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, me seli në SHBA (pa pagesë) në: <https://feedback-form.truste.com/watchdog/request>.

7. Ruajtja e të dhënave

Të dhënat tuaja personale do të ruhen për aq kohë sa do të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë mbledhur, përgjithësisht përgjatë kohëzgjatjes së çdo marrëdhënieje kontraktuale si dhe për çdo periudhë të mëtejshme, sipas dispozitave ligjore ose sa e lejon ligji i zbatueshëm. Planet e ruajtjes së të dhënave të Johnson Controls, i gjeni në: <https://my.jci.com/Ethics/Pages/RIM.aspx>.

8. Mbrojtja dhe siguria

Johnson Controls ndërmerr masa paraprake për mbrojtjen e të dhënave personale nga moshumbja, keqpërdorimi dhe qasje e paautorizuar në to, zbulimi, tjetërsimi dhe shkatërrimi i tyre. Kemi marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative për të mbrojtur sistemet e informacionit, në të cilat janë ruajtur të dhënat tuaja personale dhe u kërkojmë edhe furnitorëve dhe ofruesve të shërbimeve të mbrojnë të dhënat tuaja personale, përmes marrëveshjeve kontraktuale dhe mjeteve të tjera.

9. Të drejtat tuaja

Të drejtat tuaja varen nga legjislacioni juaj lokal. Johnson Controls do t'i nënshtrohet legjislacionit lokal në përgjigje të kërkesave të të drejtave të privatësisë, të tilla si më poshtë.

- **Informacioni dhe qasja:** Ju mund të kërkonti të keni qasje tek të dhënat tuaja personale, të pajiseni me të dhëna shtesë si dhe të pajiseni me një kopje të të dhënave tuaja personale. E drejta për informim dhe qasje ka disa kufizime. Për shembull, qasja mund të refuzohet (i) në rast të kërkesave të shpeshta për qasje brenda një kohe të shkurtër, ose (ii) atje ku kjo qasje ose korrigjim do të komprometonte privatësinë e një personi tjetër ose do të ekspozonte në mënyrë të paarsyeshme të dhëna sensitive të kompanisë.
- **Korrigjimi:** Ju mund të kërkonti të korrigjoni dhe/ose të përditësoni të dhënat tuaja të pasakta ose të vjetruara personale.
- **Fshirja:** Ju mund të keni të drejtë të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja personale. Kjo e drejtë ka kufizime.
- **Kufizimi:** Ju mund të keni të drejtë të kërkonti kufizimin e të dhënave tuaja personale. Kufizimet nënkuptojnë që të dhënat tuaja personale ruhen vetëm nga Johnson Controls dhe nuk përpunohen më tej, ndërkohë që ankesa juaj merret në shqyrtim.
- **Kundërshtimi dhe përpunimi:** Ju mund të keni të drejtën të kundërshtoni përpunime specifike të të dhënave. Këto lloj përpunimesh janë marketing i drejtpërdrejtë, përpunim për qëllime studimore ose statistikore si dhe përpunime bazuar në interesa legjitime. E drejta për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave bazuar në interesa legjitime mund t'i nënshtrohet paraqitjes së argumenteve nga ana e Johnson Controls, të cilat mund t'i mbivendosen të drejtës tuaj për kundërshtim.
- **Portabiliteti i të dhënave:** Ju mund të keni të drejtën të kërkonti mbartjen e të dhënave. Mbartja e të dhënave është paraqitja e të dhënave tuaja personale në një formë të strukturuar, të përdorimit të përgjithshëm e të lexueshme elektronikisht, për t'u transferuar lehtësisht prej nje ju ose nga Johnson Controls në një kompani tjetër. E drejta e mbartjes së të dhënave ka kufizime. Për shembull, mbartja e të dhënave nuk është e vlefshme për të dhënat në letër dhe nuk duhet të komprometojë të drejtat e të tjerëve, ose të dhënat sensitive të kompanisë.
- **E drejta për të mos iu nënshtrohet vendimeve të bazuara vetëm në vendimarrje automatike:** Ju mund të keni të drejtën të mos i nënshtroheni vendimeve të bazuara vetëm në përpunimin automatik (p.sh. pa ndërhyrje njerëzore), nëse këto vendime kanë efekte ligjore ose ju dëmtojnë ndjeshëm. Përpunimi automatik është përpunimi i të dhënave tuaja personale me mjete automatike. Nëse kryejmë përpunimin që përdor vendimarrje të automatizuar, e cila prodhon efekte ligjore ose ndikon ndjeshëm tek ti, atëherë do të kesh të drejtën që të mos jesh subjekt i një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar.

Ju mund të keni gjithashtu të drejtën të depozitoni një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës.

Ju mund të kërkonti të ushtroni secilën nga këto të drejta duke kontaktuar zyrën lokale të Burimeve Njerëzore ose Zyrën e Privatësisë në adresën privacy@jci.com.

10. Detyrimet tuaja

Ju lutemi t'i mbani të dhënat personale të përditësuara dhe të na informoni lidhur me çdo ndryshim të rëndësishëm të të dhënave personale.

Ky njoftim privatësie vlen për të dhënat personale të individëve të tjerë që na ofroni. Për shembull, përfituesit e përfitimeve të punës suaj, si individët që janë në planin tuaj të shëndetit dhe përfituesit e llogarive tuaja të pensionit, si dhe kontaktet tuaja të emergjencës dhe vartës të tjerë. Është përgjegjësia juaj që t'i informoni këta individë lidhur me këtë Njoftim Global Privatësie dhe/ose t'u jepni një kopje të këtij njoftimi atyre individëve, si dhe të siguroheni që keni të drejtë të na i jepni ne të dhënat e tyre personale.

Është gjithashtu përgjegjësia juaj të respektoni ligjin në fuqi dhe politikat, standardet dhe procedurat e kompanisë që ju janë bërë të ditura gjatë trajtimit të të dhënave personale tek të cilat keni qasje gjatë marrëdhënies suaj me ne. Veçanërisht, nuk duhet të keni qasje ose të përdorni të dhëna personale për asnjë qëllim të ndryshëm nga sa lidhet dhe deri në masën e nevojshme të punës suaj me ne. Ju e kuptoni se këto detyrime vazhdojnë të ekzistojnë pas përfundimit të marrëdhënies suaj me ne.

11. Autorizimi dhe tërheqja e autorizimit

Nëse miratimi është baza ligjore e përpunimit të të dhënave tuaja personale ose kategorive të veçanta të të dhënave personale, mund ta tërhiqni miratimin tuaj pa pagesë, duke kontaktuar Zyrën e Privatësisë në privacy@jci.com (atje ku tërheqja kërkohet dhe/ose lejohet nga ligji në fuqi).

12. Modifikime të Njoftimit tonë të Privatësisë

Ne mund ta modifikojmë këtë njoftim herë pas here, nëse është e nevojshme. Nëse propozojmë të bëjmë ndryshime materiale, do të të njoftojmë me anë të një njoftimi në këtë faqe. Ky njoftim mund të plotësohet gjithashtu edhe me deklarata të tjera, sipas nevojës, në përputhje me kërkesat lokale në vendin ku jetoni, ose ku janë lidhur marrëveshjet e përfaqësisë së punonjësve.

13. Çështje të privatësisë dhe Si të na kontaktoni

Nëse keni pyetje lidhur me këtë njoftim ose nëse mendoni se të dhënat tuaja personale nuk janë trajtuar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm ose me këtë njoftim, keni mundësitë e mëposhtme:

- Kontaktoni me Zyrën e Privatësisë në adresën privacy@jci.com;
- Kontaktoni me zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave në adresën dpo@jci.com
 - Diskutojeni çështjen me supervizorin tuaj ose me një supervizor apo menaxher tjetër;
- Kontaktoni departamentin e Burimeve Njerëzore; ose
- Mund të kontaktoni gjithashtu me linjën 24-orëshe Integrity Helpline të Johnson Controls në: www.johnsoncontrolsintegrityhelpline.com.